

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXI, nr. 6524  
E martë, 1 shkurt 2022  
çmimi 0.40

Diçka për censurën në 2007,  
prapaskena me amerikanët  
që thurnin pavarësinë dhe  
vrasjet e 10 shkurtit.. | FAQE 2

Muhamet  
MAVRAJ



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

ZËVENDËSNDIHMËSSEKRETARI I SHBA-SË, NJËHERËSH PËRFAQËSUES SPECIAL PËR BALLKANIN PERËNDIMOR, GABRIEL ESCOBAR, DHE PËRFAQËSUESI SPECIAL I BE-SË PËR DIALOGUN KOSOVË - SERBI, MIROSLAV LAJÇAK, KANË VIZITUAR KOSOVËN

## SHBA-ja DHE BE-ja PËRCJELLIN MESAZH SE PO PUNOJNË NGUSHTË PËR DIALOGUN



Përfaqësues special i presidentit amerikan për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar dhe përfaqësuesi special i BE-së për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, kanë bërë me dije se ShBA-ja dhe BE-ja ndajnë vizionin e njëjtë për dialogun Kosovë - Serbi. Pas takimit me presidenten e Kosovës dhe kryeministrin Albin Kurti, ata kanë thënë se ky proces do ta afrojë më shumë Kosovën drejt Bashkimit Evropian

### AKTUALE



SHBA-ja DHE BE-ja PËRKRAHIN  
INSTITUCIONET NË STRATEGJINË  
PËR SUNDIMIN E LIGJIT F. 3

KOSOVA REGJISTRON TRI VIKTIMA  
DHE 1 593 RASTE TË REJA ME  
COVID F. 5

LIMAJ PËRKUJTON BASHKËLUFTË-  
TARIN HARADIN BALA F. 6



### EKONOMI

## Zahiri, Edmondi dhe Hakifi ishin lajmëtarët e lirisë

FAQE 7



## SPECIALJA KRITIKOHET PËR MBYLLJE TË SEANCAVE DHE REDAKTIME TË ASHPRA

FAQE 3



DËRGOHEN KOMENTET PËR  
STRUKTURËN E RE TARIFORE TË  
PROPOZUAR NGA ZRRE-ja F. 8

### SPORT



DREJTUESIT E FFK-së MORËN PJESË  
NË MBLEDHJEN E TEP-it F. 10

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

# Diçka për censurën në 2007, prapaskena me amerikanët që thurnin pavarësinë dhe vrasjet e 10 shkurtit...



**PRISHTINË, 31 JANAR** - Profesori universitar, publicisti dhe botuesi i gazetës "Epoka e re", Muhamet Mavraj, në një shkrim të publikuar në llogarinë e vet në "Facebook", ka shkruar për censurën e vitit 2007 ndaj medias që drejton me rastin e publikimit të draftit të planit të Ahtisarit i cili ishte sekret dhe të cilin mori vendim ta botojë, për disa prapaskena me amerikanët që thurnin lavde për pavarësinë, pastaj për vrasjet e 10 shkurtit, për pushtetin absurd si dhe "për disa mësimë edhe për servilët", ka shkruar Mavraj.

Ai ka treguar se "pavarësisht prej presionit dhe sikletit të fortë, në mëngjes, më 1 shkurt, do të botohej ose do ta mbyllja gazetën përgjithmonë". "Paralajmëruam në televizion se do ta botojmë: 'Ne e botojmë, s'na ninë'. Tetë minuta pas kësaj fjalie ata thirrën. 'Ju flasim drejtpërdrejt nga Uashingtoni!' Pavarësisht prej presionit dhe sikletit të fortë, në mëngjes, më 1 shkurt, do të botohej ose do ta mbyllja gazetën përgjithmonë. 'Natën e mirë, miq!' Por, ata thirrën përsëri. 'Uashingtoni ka vetëm një pyetje...' - 'Ju duam, por drafti do të botohet dhe, po, meqenëse pyetët, jam plotësisht i vetëdijshëm çfarë po bëj, pse po e bëj dhe do ta bëj. Unë bëj punën time, Ju vazhdoni me Tuajën!' Për kundërpërgjigje, pa u lëshuar në retorikë të budallme, nënshkrova pa koment një leksion të gatshëm nga historia amerikane e kohës së Kenedit, me titull shpotitës: ai nga varri po na këshillon të bëjmë kështu! Sekreti i 'madh' që e solli Ahtisari ishte sekret publik", ka shkruar Mavraj.

**Shkrimi i plotë i Muhamet Mavrajt:**

Diçka për censurën më 2007, për disa prapaskena me amerikanët që thurnin pavarësinë, pastaj për vrasjet e 10 shkurtit... për këtë pushtet absurd... Shkurt, disa

mësimë edhe për servilët. 31 janari i vitit 2007 ka qenë ditë e zezë për profesionin e gazetarisë. Një gazetë e jona doli me ballinë të çuditshme. "Pa dokument", sepse "Na u tha të mos e botojmë", shkruhej në ballinë. Katër faqe dolën bosh sepse ishin fshirë gjatë natës në shtypshkronjë. Përmbanin draftin "sekret" të Ahtisarit, pa anekset. Pritej që më 2 shkurt vetë ai ta sillte në duart e zyrtarëve në Kosovë, ndërsa botimi paraprak, pandehej, mund ta shkatërronte ardhjen e tij dhe revoltonte qytetarët. Censurimi na poshtëroi! Paralajmëruam në televizion se do ta botojmë: "Ne e botojmë, s'na ninë". Tetë minuta pas kësaj fjalie ata thirrën. "Ju flasim drejtpërdrejt nga Uashingtoni!"

Pavarësisht prej presionit dhe sikletit të fortë, në mëngjes, më 1 shkurt, do të botohej ose do ta mbyllja gazetën përgjithmonë. "Natën e mirë, miq!" Por, ata thirrën përsëri. - "Uashingtoni ka vetëm një pyetje..." - "Ju duam, por drafti do të botohet dhe, po, meqenëse pyetët, jam plotësisht i vetëdijshëm çfarë po bëj, pse po e bëj dhe do ta bëj. Unë bëj punën time, Ju vazhdoni me Tuajën!" Për kundërpërgjigje, pa u lëshuar në retorikë të budallme, nënshkrova pa koment një leksion të gatshëm nga historia amerikane e kohës së Kenedit, me titull shpotitës: ai nga varri po na këshillon të bëjmë kështu! Sekreti i "madh" që e solli Ahtisari ishte sekret publik. Më 10 shkurt 2007 u mbajt protestë me retorikë të zjarrtë kundër Ahtisarit dhe shumë urrejtje kundër "Grupit të unitetit", sidomos kundër atyre që "ëndërrojnë Titon dhe Jugosllavinë". U kryen vrasje dhe plagosje tërësisht të paarsyeshme nga Unmiku, çuditërisht me mbulim retorik nga zëdhënësit e atëhershëm qeveritarë. Shquhej edhe një politikan oficer në rol eksperti të sigurisë kur i bënte analizën kokës së turmës që mësyu kordonin e policisë, (metoda e "pykës" thoshte me zell oficeri që sot bën iso edhe për këtë qeveri

që udhëhiqet pikërisht nga "pyka".) Mendoja se i kemi ftohur raportet pas 1 shkurtit 2007 por, për çudi, Zyra e Madhe kërkoi dy takime në selinë e saj, të parin kur do të shtyhej shpallja e pavarësisë shkaku i francezëve dhe, të dytin, para shpalljes së pavarësisë në shkurt 2008. Këtu munda të vë bast se "këtë të diel, ose të dielën një javë do të shpallet pavarësia" dhe bindjen time ia kam përcjell kokoshit, nëpërmjet aktivistit Dritan Dragusha, që të mos betohet kundër aq pa lidhje. Pjesë nga fjala ime atje brenda: - Ne dimë të festojmë, zonja ambasadore, Kaydanov. Ju falënderoj që po merreni edhe me detajet më të imëta, por pse bëhet temë kjo... Pavarësia nuk do të pengohet që të shpallet, nuk do të ketë paraprakisht incidente, do të shpallet dhe ti sigurisht do të jesh ambasadorja e parë e akredituar këtu. Gjithashtu, në ditën e shpalljes së pavarësisë nuk do të sulmohet askush, nuk do të hakmerremi për të kaluarën, do të festojmë qetë, jemi popull i civilizuar, ushtarët tanë, lexuesit tanë kanë festuar edhe më herët dhe nuk do të thyhet asnjë gotë në Kosovë, asnjë! Kamerat dhe vëmendja e botës do të mbesin vetëm në Prishtinë...". Pak javë pas pavarësisë, ai

Uashingtoni i 31 janarit të acartë të një viti më parë, solli në zyrë ftesën për vizitë atje dhe për specializim në cilindo universitet amerikan që do të përzgjedhja nga lista e tyre. Më bënë përshlyetje fillimet e përsëritura të fjalive që i theksonte drejtoresha e informacionit kombinuar edhe me gjuhën e duarve dhe të fytyrës: Shtetet e Bashkuara të shprehin mirënjohjen më të lartë... Shtetet e Bashkuara vlerësojnë lart patriotizimin, analizën e saktë dhe inteligjencën tënde... Shtetet e Bashkuara të mirëpresin në tokën tonë, të ftojnë për vizitë dhe je i lirë të zgjedhësh vendet për vizitë dyjavore dhe tutje Universitetin... Shtetet e Bashkuara...". Sa zonja e zotërinj të mëdhenj që janë dhe sa të ndryshëm nga psikopatët bolshevikë. 13 vjet më vonë, më 10 shkurt 2020, lideri i protestës së atëhershme, kryeministër në mandat të parë, kërkoi drejtësi, por nga Unmiku? Dhe, jo bash krejt për habi, në pushtetin e sotëm, presidencë, qeveri e parlament dhe oborreve të tyre sa mirë ia çojnë ata që ishin në krye të protestës dhe ata e ato që ishin atëherë në Qeveri, ose arsyetues a shpirtërisht përkrahës të vrasjeve, përfshirë "jugosllavët" dhe unmikasit vendorë, për dhe kundër pavarësisë. Lol! Ky stan atë bulmet ka!

**lajm**  
Mërkurë, 31 JANAR 2007 - CHINI 10 CENTE  
Drejtori Përcaktim, lideri i Asociatës Kosovë e Ma, u prezantoi studentëve me raportin i ndërkombëtar i tyre dhe të zotë vendin që e merretin

**Pavarësinë duhet ta ndërtojmë vetë**

"Dokument i Ahtisarit është i rëndësishëm, por çfarë bëjmë me të? Ahtisari, siç na thanë, draftin e Ahtisarit, e hoqëm nga faqet. Duke besuar në këtë, këto faqe mbesin të bardha. Kërkojmë ndjesë!"

**Pa dokument!**  
Faqet 4, 5, 6 dhe 7 në momentin e fundit mbetën pa draftin e Ahtisarit. Na u tha të mos e botojmë

**EPOKA E RE**  
Epërditshme e pavarur  
Viti VII, nr. 202  
E mërkurë, 1 shkurt 2007  
Çmimi 4.20 €

**Me dokument JA DOKUMENTI**

Një rend të shtyrë prej mijëvjeçarëve bota e re që të mos botonet dokumenti për Kosovën

**Urdhri i presidentit Kennedy për "Epokën e re": Botojeni dokumentin e Ahtisarit!**

John Fitzgerald KENNEDY (1917-1963), president i 35-të i SHBA-së, ishte bërë që të kalonte me garancë të sigurt në fillim të viteve të 1960-tës. "Lidhur me interes të kombëtar, që shpallje të qëndrueshme të jone", u tha ai. Dhe në shkurt të '67-tës, u përcaktua me një mision të "Shkëlqimit". Presidenti amerikan u marrëzua. Shkëlqimi i Presidentit Kennedy ishte qartësisht: Dëshmia. Përkrahje. Në fund, Kennedy tha:

"Ekipi përshlyet që media amerikane, publike, mbeti me mend për raportin që ai të rikrahën në 'Gjiri e Duanës'..."

"Zoti President", ja na prezantim të reas shkëlqimin, dhe një qartësi! Sot themi të fundit. Ekipi kopoi qepë harro!"

"Urdhri i Presidentit për bërë garancë të sigurtit të gazetës!"  
Kur thuhet që media amerikane, publike, mbeti me mend për raportin që ai të rikrahën në 'Gjiri e Duanës'... një bërë detyrën time si president. Lidhur me interes të kombëtar, që shpallje të qëndrueshme të jone. Dhe në shkurt të '67-tës, u përcaktua me një mision të "Shkëlqimit". Presidenti amerikan u marrëzua. Shkëlqimi i Presidentit Kennedy ishte qartësisht: Dëshmia. Përkrahje. Në fund, Kennedy tha: "Ekipi përshlyet që media amerikane, publike, mbeti me mend për raportin që ai të rikrahën në 'Gjiri e Duanës'..."

Në mesin e studentëve  
Muhamet Mavraj

MBAHET TAKIMI I PARË I KOMITETIT DREJTUES TË STRATEGJISË PËR SUNDIMIN E LIGJIT

## ShBA-ja dhe BE-ja përkrahin institucionet në Strategjinë për Sundimin e Ligjit

Përfaqësues të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (SHBA) dhe Bashkimit Evropian (BE) kanë marrë pjesë të hënën në takimin e parë të Komitetit Drejtues të Strategjisë për Sundimin e Ligjit. Ata u kanë ofruar përkrahje institucioneve të Kosovës në Strategjinë për Sundimin e Ligjit. Ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka thënë se vizioni kryesor i këtij dokumenti planifikues është kthimi i besimit të qytetarëve në drejtësi

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 31 JANAR - Ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, në bashkëkryesim me kryesuesin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK), Albert Zogaj dhe kryesuesin e Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK), Jetish Maloku, kanë mbajtur të hënën mbledhjen e parë të Komitetit Drejtues të Strategjisë për Sundimin e Ligjit në të cilën kanë marrë pjesë përfaqësues të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare.

Në takimin e këtij komiteti temë diskutimi ishte procesi tejte i rëndësishëm i zbatimit të strategjisë dhe planit të veprimit, dokument strategjik që nuk përfaqëson vetëm jetësimin e vizionit të reformës në drejtësi, por dokumentin konkret të konsolidimit të sistemit të drejtësisë në vend si rezultat i procesit të rishikimit funksional të sektorit të sundimit të ligjit.

Derisa ka folur për rëndësinë e Strategjisë dhe planit të veprimit, ministrja Haxhiu ka thënë se vizioni kryesor i këtij dokumenti planifikues është kthimi i besimit të qytetarëve në drejtësi, për të cilin, shtoi Haxhiu, duhet punuar pareshur për arritjen e tij.

Nga ana tjetër, kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Albert Zogaj, ka shprehur vlerësimin e tij për këtë strategji, aktivitetet e së cilës, ka thënë ai, janë adresuar dhe analizuar brenda KGJK-së. Kryesuesi Zogaj u zotua se KGJK-ja mbetet e përkushtuar për



bashkërendim të plotë me qëllim të zbatimit të tërësishëm të kësaj strategjie për të ofruar një drejtësi të barabartë dhe efikase për qytetarët dhe njëherësh duke synuar objektivin kryesor, kthimin e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë për të cilat zotime, shtoi ai, KGJK-ja do të jetë mbështetës i fuqishëm si institucion dhe i përgjegjshëm për zbatim të kësaj strategjie.

Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, Jetish Maloku, ka thënë se procesi i rishikimit funksional të rishikimit të sektorit të sundimit të ligjit është një ndër proceset më

të rëndësishme për sistemin e drejtësisë, nga i cili proces edhe derivon kjo strategji, për të cilën janë të përkushtuar për zbatimin e mëtutjeshëm të saj. "Me qëllim që të kemi një sistem drejtësie të pavarur, transparente dhe efikase", ka pohuar ai.

Përfaqësuesi nga Ambasada Amerikane, Michael W Grant, në fjalën e tij i ka përgëzuar përfaqësuesit e institucioneve për punën e bërë, duke shtuar se ShBA-ja mbetet e përkushtuar që të ofrojë mbështetje të vazhdueshme për implementimin e plotë dhe të

suksesshëm të Strategjisë dhe Planit të Veprimit. Gjithashtu, ai i bëri thirrje qeverisë që t'i ofrojë burimet e nevojshme për zbatim të aktiviteteve që dalin nga plani i veprimit dhe të ekzistojë bashkëpunimi në mes të aktorëve përkatës për zbatimin e strategjisë.

Përfaqësuesja nga Zyra e BE-së në Kosovë, Annemarie Douwes, ka theksuar se BE-ja e mirëpret zbatimin e Strategjisë dhe planit të veprimit e cila është bazë për modernizimin e sektorit të sundimit të ligjit dhe për këtë BE-ja e ka mbështetur dhe do të

vazhdojë ta mbështesë zbatimin e saj përmes projekteve apo aktiviteteve të ndryshme.

Për rëndësinë e kësaj Strategjie ka folur edhe përfaqësuesi nga Presidenca, Artan Murati, i cili i ka njoftuar të pranishmit që në Samitin për Demokraci të organizuar nga presidenti Biden është diskutuar edhe zbatimi në përpikëri i kësaj strategjie. Ndër të tjera, në këtë mbledhje u votuan funksionalizimi i organit koordinues ndërinstitucional si dhe anëtarit i këtij komiteti nga radhët e shoqërisë civile, Labinot Leposhtica, BIRN.

## KDI-ja: ShSKUK-ja përmes procedurës emergjente dëmton buxhetin për 42 000 euro



PRISHTINË, 31 JANAR - Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka njoftuar se më 15 dhjetor 2021 Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) ka nënshkruar një kontratë me

kompaninë "Madedos" për furnizim me maska kirurgjikale dhe dorëza. "Çmimi i kontratës është 150 035 euro, me një kohëzgjatje prej 3 muajsh. ShSKUK-ja përdori procedurën

e negociuar për shkak se tenderi i hapur për të njëjtat produkte është me ankesë në Organin Shqyrtues të Prokurimit. Mirëpo ShSKUK-ja nuk i ka ftuar të gjithë operatorët që kanë ofertuar në tenderin e hapur që të ofertojnë edhe në tenderin me negociim. ShSKUK ka pranuar çmime më të larta se ofertat e pranuar nga e njëjta kompani për maska kirurgjikale. 'Madedos' ka ofertuar 0.03 euro në tenderin e hapur, ndërsa në tenderin me procedurë të negociuar, 0.04 euro", ka njoftuar KDI-ja.

Sipas këtij njoftimi, ShSKUK-ja ka ftuar vetëm edhe një kompani tjetër për të ofertuar në procedurën e negociuar, por e cila ka dhënë një çmim më të

lartë. "Si rezultat i kufizimit të konkurrencës, ShSKUK-ja ka pranuar çmime më të larta. Gjithashtu, nuk ka ndonjë dëshmi se ShSKUK-ja ka tentuar që të negociojë për ta ulur çmimin. Përdorimi i procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë, nënkupton që autoriteti kontraktues duhet të tentojë që të negociojë dhe ta ulë çmimin. ShSKUK-ja është dashur të ftojë të gjithë operatorët ekonomikë që kanë ofertuar në tenderin e hapur në mënyrë që të marrë çmime më të lira. Një nga parimet bazë të prokurimit është konkurrenca dhe është vërtetuar se kur rritet niveli i konkurrencës ka mundësi më të mëdha që të ketë çmime më të ulëta", thuhet

në njoftim. Sipas KDI-së, një nga operatorët ekonomikë që ka marrë pjesë në tenderin e hapur, "Ardi Sh.PK" është ankuar me pretendimin se nuk është ftuar që të marrë pjesë në tenderin e negociuar dhe se do të mund që këto produkte t'i ofertonte me çmim prej 90 000 eurosh, pra rreth 60 000 më lirë se çmimi i kontratës. "Nëse kontrata do të llogaritej me çmimet e ofertuara në tenderin e hapur atëherë ShSKUK-ja do të paguante rreth 108 000 euro. Një vendim i paanalizuar mirë, që të përdoret procedura e negociuar dhe të ftohen vetëm dy operatorë ekonomikë, ka bërë që ShSKUK-ja të dëmtojë buxhetin e saj për rreth 42 000 euro", është bërë me dije në njoftimin e KDI-së.



ZËVENDËSNDIHMËSSEKRETARI I SHBA-SË, NJËHERËSH PËRFAQËSUES SPECIAL PËR BALLKANIN PERËNDIMOR, GABRIEL ESCOBAR, DHE PËRFAQËSUESI SPECIAL I BE-SË PËR DIALOGUN KOSOVË - SERBI, MIROSLAV LAJÇAK, KANË VIZITUAR KOSOVËN

# ShBA-ja dhe BE-ja përcjellin mesazh se po punojnë ngushtë për dialogun

Përfaqësues special i presidentit amerikan për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar dhe përfaqësuesi special i BE-së për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, kanë bërë me dije se ShBA-ja dhe BE-ja ndajnë vizionin e njëjtë për dialogun Kosovë - Serbi. Pas takimit me presidenten e Kosovës dhe kryeministrin Albin Kurti, ata kanë thënë se ky proces do ta afrojë më shumë Kosovën drejt Bashkimit Evropian

EPOKA E RE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 31 JANAR - Përfaqësuesi special i presidentit amerikan për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, dhe përfaqësuesi special i BE-së për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, kanë bërë me dije se ky proces do ta afrojë më shumë Kosovën drejt Bashkimit Evropian. Pas takimit me kryeministrin Albin Kurti, diplomati amerikan ka deklaruar se Ballkani Perëndimor është mundësi e jashtëzakonshme për Bashkimin Evropian dhe jo rrezik. Ai ka konfirmuar mbështetjen amerikane për Kosovën, duke thënë se mbështesin fuqishëm pavarësinë e Kosovës. "Për Kosovën dhe rajonin ne e shohim këtë zonë si një mundësi të jashtëzakonshme me energji të jashtëzakonshme. Ju jeni evropianë, ekonomikisht, historikisht dhe kulturalisht jeni evropianë dhe ne kemi punuar me kolegët tanë evropianë për t'u

siguruar se ata e njohin që Ballkani Perëndimor është një mundësi e jashtëzakonshme për ta dhe jo rrezik. Në këtë kuptim, ne i inkurajojmë të gjitha palët që ta shohin Ballkanin Perëndimor si anëtar potencial i BE-së në të ardhmen, që të gjithë në paqe me njëri-tjetrin, që të gjithë produktivë dhe anëtarë të aftë, ashtu siç i kemi parë ne si partnerë bilateralë. Shpresa kryesore për këtë është nëpërmjet dialogut", ka deklaruar Escobari. Diplomati amerikan ka thënë se dialogu i Brukselit ka përkrahjen e plotë të ShBA-së. "Dialogu ka mbështetjen tonë të plotë dhe duhet të udhëhiqet nga BE-ja sepse ka të bëjë me Evropën. Por, teksa ju lëvizni drejt BE-së, ju do të vazhdoni të jeni miq të ngushtë të ShBA-së sepse është një partneritet trans-atlantik, komunitet trans-atlantik që ju veçse jeni pjesë dhe ky dialog do t'ju afrojë edhe më shumë", ka thënë Escobari. Përfaqësuesi special i Bashkimit

Evropian për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, në konferencë për medie, pas takimit me kryeministrin Albin Kurti, ka thënë se kjo vizitë e përbashkët tregon se BE-ja dhe ShBA-ja po punojnë "ngushtë" për dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë dhe për vizionin e së ardhmes. "Jam i lumtur se vizita ka ofruar mundësi për të diskutuar planin tonë për muajt e ardhshëm e javët e ardhshme me presidentin, me kryeministrin. Do t'i vazhdojmë diskutimet tona. Do të qëndrojmë deri të mërkurën, do të na ndihmojnë të kemi pamje të qartë se çfarë të presim në të ardhmen që ta shtyjmë procesin para. Do të informojmë për vizitën. Në këtë pikë dua të them se jemi të lumtur që jemi këtu bashkë", ka thënë ai. Kurse kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se janë të vendosur që integriteti territorial të mbetet i paprekshëm. Ai ka thënë se Qeveria e Kosovës mbështet dialogun Kosovë - Serbi. "Qeveria e

Republikës së Kosovës e mbështet procesin parimor në Bruksel. Ne jemi të vendosur që integriteti, sovraniteti, kushtetutshmëria tërë kohën dhe kudo të ngelen të pacenuara nga çfarëdo e ndokush. Unë jam kryeministër i qytetarëve pa dallim, prandaj jam i gatshëm t'u përgjigjem të gjitha kërkesave të qytetarëve të Kosovës. Ne dëshirojmë ndihmën e BE-së. Fondet dhe vlerat evropiane ne i shohim të pashkëputshme ndaj njëra-tjetres", ka thënë Kurti. Dy diplomatët ndërkombëtarë ai i ka njoftuar edhe për reformat në ekonomi dhe drejtësi. "Kemi shënuar në vitin e kaluar 10 mijë vende pune të reja dhe kemi pasur rritje ekonomike prej 9.9-

përqindësh sipas Bankës Qendrore të Kosovës, rritje të të hyrave tatimore, rritje të buxhetit dhe, gjithashtu, rritje për afër 60 për qind të investimeve të huaja. Jemi të vendosur t'u shërbejmë të gjithë qytetarëve pa dallim. Qeveria e Kosovës e mbështet dhe është e angazhuar për procesin e bisedimeve në Bruksel", ka thënë Kurti.

**Osmani: Serbia, bllokuese e përparimin në dialog**

Edhe presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur të hënën në takim përfaqësuesin special të BE-së, Miroslav Lajçak dhe



# Specialja kritikohet për mbyllje të seancave dhe redaktime të ashpra

Prishtinë, 31 janar - Monitoruesit e punës së Dhomave të Specializuara të Kosovës kanë vlerësuar se ky institucion është duke trajtuar me profesionalizëm të drejtat e të akuzuarve dhe palëve të tjera në procedurë. Megjithatë, Amer Alija, koordinator në Fondin për të Drejtën Humanitare në Kosovë, ka thënë se Dhomat e Specializuara në seancat gjyqësore që janë zhvilluar deri më tani, në veçanti në rastin kundër ish-eporit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Salih Mustafa, kanë qenë aq të redaktuara sa që ka qenë e vështirë të kuptohet nga monitoruesit se për çfarë në të vërtetë flitej në seancë.

Këto komente Alija i bëri në një debat publik të organizuar nga Fondi për të Drejtën Humanitare, të hënën, më 31 janar. "Seancat në rastin e Salih Mustafës kanë qenë tejet të redaktuara. E dimë që këto redaktime bëhen për shkak të

sigurisë së dëshmitarëve, por nga 12 dëshmitarë, dhjetë prej tyre kanë qenë të redaktuara apo të mbyllura, ku mbi 70 për qind të seancave kanë qenë shumë të redaktuara dhe një monitorues laik do ta ketë të vështirë për të kuptuar se çfarë është duke ndodhur brenda seancave", ka thënë Alija. Ai ishte kritik edhe sa iu takon fazave përgatitore për procese gjyqësore që, sipas tij, Dhomave të Specializuara po u merr kohë të gjatë.

Udhëheqësja e Njësisë së Informimit dhe Komunikimit Publik në kuadër të Dhomave të Specializuara të Kosovës, Angela Griep, ka thënë se redaktimet e shumta si dhe kalimi në seanca private bëhet me qëllim të mbrojtjes së dëshmitarëve. "Ekzistojnë shpesh arsye shumë të forta pse gjyqtarët vendosin që të kalojnë në seanca të mbyllura dhe pse gjyqtarët vendosin që

dokumentet duhet të redaktohen dhe kjo arsye, në të shumtën e rasteve, ndodh për t'i mbrojtur dëshmitarët apo njerëzit e tjerë të cilët janë në një formë apo tjetër pjesë e procedurës", ka pohuar Angela Griep.

Duke folur për punën e Dhomave të Specializuara në këtë debat, avokati Artan Qerkini ka thënë se çështja e mbylljes së seancave ka ndikuar që opinioni të mos mund ta përcjellë rrjedhën e gjyqësorisë. "Unë e kuptoj se edhe mbrojtja e dëshmitarëve është një çështje për të cilën duhet pasur kujdes gjykata, mirëpo në anën tjetër parimi i publicitetit është pjesë e gjyqësorisë dhe të paanshëm dhe nëse i kemi redaktimet, plus mungesën e publicitetit, atëherë thjesht opinioni po mbetet i mangët në lidhje me përcjelljen e rrjedhës së procedurës", është shprehur Qerkini.

Një kritikë tjetër për Dhomat e

Specializuara ishte edhe mungesa e përkthimeve të disa materialeve gjyqësore në gjuhën shqipe dhe atë serbe. "Si vërejtje do ta veçoja mungesën e publikimit të këtyre shkresave në tri gjuhë. Pra, kryesisht shkresat që lëshohen nga Dhomat e Specializuara publikohen vetëm në një gjuhë, por nuk publikohen edhe në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbe", ka theksuar Alija.

Si pozitive nga monitoruesit e punës së këtij institucioni u vlerësua fakti se proceset gjyqësore ose shqyrtimet kryesore mbahen me një intensitet të lartë dhe me një profesionalizëm të dukshëm, ku të drejtat e palëve në procedurë, sipas tyre, janë duke u respektuar në mënyrë maksimale.

Aktualisht në Dhomat e Specializuara të Kosovës janë duke u zhvilluar dy procese gjyqësore, njëri ndaj ish-eporit të UÇK-së, Salih Mustafa, tjetri ndaj udhëheqësve të Organizatës së

Veteranëve të Luftës së UÇK-së, Hysni Gucati e Nasim Haradinaj.

Procesi gjyqësor ende nuk ka filluar ndaj ish-presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, ish-kryetarit të Partisë Demokratike të Kosovës, Kadri Veseli, ish-kryetarit të Kuvendit të Kosovës, Jakup Krasniqi, si dhe ish-deputetit të Lëvizjes Vetëvendosje, Rexhep Selimi.

Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar janë themeluar me vendim të Kuvendit të Kosovës në gusht të vitit 2015 dhe mision kanë hetimin e krimeve të pretenduara të ish-pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të kryera kundër pakicave etnike dhe rivalëve politikë, nga janari i vitit 1998 deri në dhjetor të vitit 2000.

Pretendimet për këto krime të supozuara janë përmendur për herë të parë në një raport të Këshillit të Evropës në vitin 2011, autor i të cilit është senatori zviceran Dick Marty.



## Kosova regjistron tri viktima dhe 1 593 raste të reja me Covid

Prishtinë, 31 janar - Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se janë regjistruar edhe tri viktima dhe 1 593 raste të reja me Covid-19. Sipas njoftimit, në 24 orët paraprake janë

kryer 6 837 testime, që i bie se 23.29 për qind e personave të testuar kanë dalë pozitivë me sëmundjen Covid-19.

Po ashtu, Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se

janë shëruar 2 433 persona. Raste aktive aktualisht janë 34 208.

Sa i përket vaksinimit, në 24 orët paraprake janë administruar 943 doza të

vaksinës. Deri më tani me dy doza të vaksinës janë imunizuar 805 226 persona. Në Kosovë të drejtë vaksinimi kanë të gjithë personat nga moshë 12-vjeçare. Ndërkaq,

personat nga moshë 18-vjeçare, që janë imunizuar me të dyja dozat e vaksinës para tre muajsh, mund të imunizohen edhe me dozën përfunduese apo atë të tretë.

zëvendësndihmësekretarin e ShBA-së, njëherësh përfaqësues special për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, me të cilët ka diskutuar për zhvillimet në dialog dhe se si mund të ecet përpara me dialogun Kosovë - Serbi me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian dhe me mbështetjen e Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Sipas Zyrës për Informim të Presidencës, presidentja Osmani ka theksuar se Republika e Kosovës është e përkushtuar për dialog që ka në qendër njohjen reciproke dhe u shpreh se Kosova e ka dëshmuar këtë me angazhimin e saj aktiv dhe me propozimet e bëra përgjatë procesit. Ajo, gjithashtu, ka përsëritur qëndrimin e Kosovës se marrëveshja për

njohje reciproke nuk duhet ta prekë sovranitetin, integritetin territorial dhe rendin kushtetues të Kosovës. "Është tashmë e qartë se Serbia po e bllokoi përparimin në dialog nëpërmjet qasjes së saj jokonstruktive", ka potencuar presidentja.

"Duke vënë në pah konstruktivitetin e Kosovës, presidentja, gjithashtu bëri të qartë

se lista e marrëveshjeve që nuk janë zbatuar nga Serbia është e gjatë dhe duhet të trajtohet urgjentisht nëse duam ta rivendosim besimin në procesin e dialogut. Ajo tha se Serbia jo vetëm që vazhdon të mos zbatojë marrëveshjet e mëparshme, por ajo shfaq pengesa të qarta sa herë që marrin pjesë në takimet e organizuara në kuadër të dialogut

në Bruksel. Në këtë drejtim presidentja tha se pret trajtim të barabartë të palëve në këtë proces nga ana e Bashkimit Evropian si ndërmjetësues i dialogut", ka njoftuar Presidencën.

Presidentja Osmani, po ashtu, ka theksuar edhe një herë rëndësinë absolute të ndriçimit të fatit të personave të zhdukur me dhunë si prioritet i procesit të dialogut.

## Përkujtohen dëshmorët Enver e Shani Morina dhe Sahit Shala

Drenas, 31 janar - Me rastin e shënimit të 32-vjetorit të rënies së tre dëshmorëve, Enver Morina, Shani Morina dhe Sahit Shala, të rënë në demonstratat e vitit 1990, kryetari i komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci me bashkëpunëtorë, familjarë të të rënëve dhe qytetarë, kanë bërë homazhe dhe kanë vendosur buqeta

me lule të freskëta në vendin e rënies së tyre, ku është edhe pllaka përkujtimore, te vendi i quajtur "te rampa" në Drenas.

Kryetari Lladrovci ka thënë se sakrificat e tyre dëshmon më së miri se qytetarët kishin nisur qysh herët kundërshtimin e regjimit serb për lirinë e kufizuar dhe regjimet e ashpra që ishin

instaluar në Kosovë nga Serbia.

Më 31 janar të vitit 1990, te vendi i ashtuquajtur "Te rampa", në demonstratat e organizuara nga shumë qytetarë të komunës së Drenasit, forcat serbe vranë Enver e Shani Morinën dhe Sahit Shalën, ndërsa plagosën 27 protestues të tjerë.



## Kuvendi i Malishevës miraton buxhetin për vitin 2022



Malishevë, 31 janar - Kuvendi i Komunës së Malishevës ka rishqyrtuar dhe shfuqizuar vendimin me nr. 02/04, datë 10.01.2022, për miratimin e buxhetit të komunës së Malishevës për vitet 2022-2024, me theks të veçantë për vitin 2022.

Drejtori për Ekonomi, Buxhet dhe Financa, Blerim Thaçi, ka paraqitur projekt-buxhetin për vitin 2022 para këshilltarëve, kurse më pas është debatuar nga këshilltarët për buxhetin si dhe janë propozuar kërkesat përmes përfaqësuesve të subjekteve politike.

Në fund të mbledhjes Kuvendi

Komunal me shumicë të votave ka miratuar projekt-buxhetin e komunës së Malishevës për vitet 2022-2024, me theks të veçantë për vitin 2022, në vlerë prej 15,655,757 eurosh që, krahasuar me vitin e kaluar, është rreth 755 mijë euro më i lartë.

Nënkryetari i komunës së Malishevës, Vesel Krasniqi, i ka falënderuar të gjithë anëtarët e Kuvendit Komunal që përkrahen miratimin e këtij projekt-buxheti, që për synim ka fillimin e realizimit të projektit për Malishevën urbane dhe përkrahjen e të gjithë projekteve të sektorëve të tjerë, me interes të përgjithshëm qytetar.

## Komuna e Prizrenit rrënon një objekt të kontestuar për shumë vjet në lagjen 'Dardania'

PRIZREN, 31 JANAR - Drejtorja e Inspektorateve në Prizren ka filluar kthimin në gjendjen e mëparshme të hapësirës ku është planifikuar objekti i banimit kolektiv në lagjen 'Dardania'. "Me qëllim të harmonizimit të kërkesave dhe obligimeve që dalin nga aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese dhe në zbatim të

vendimit të kuvendit të komunës, të datës 13 tetor 2021, vendim i cili e obligon komunën e Prizrenit t'i ndërmarrë veprimet e nevojshme ligjore, autoritetet komunale, gjegjësisht Drejtorja e Inspektorateve, sot ka filluar rrënimin e objektit i cili është kontestuar nga banorët e lagjes 'Dardania'.

Me këtë rast komuna e Prizrenit po zbaton vendimin e Kuvendit të Komunës në përputhje me aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, po ashtu po përmbush kërkesat e banorëve të lagjes 'Dardania'. Plane dhe projekte të reja kreative e presin këtë lagje", ka njoftuar komuna e Prizrenit.



## Rama premton që kryeqyteti do ta ketë zonën e vet ekonomike

PRISHTINË, 31 JANAR - Kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama, ka pritur të hënën në takim përfaqësues të Klubit të Prodhuesve, me të cilët ka diskutuar rreth kërkesës së tyre që Prishtina ta ketë zonën e vet

ekonomike. "Kjo zonë, të cilën e kam edhe premtim elektoral, do të shërbejë edhe si qendër e kreativitetit/inovacionit ku mund të kryhen shërbime të shumta. U paraqiten sfidat të cilat kompanitë vendore

ballafaqohen dhe si mund të punojmë së bashku që në të ardhmen e afërt të evitojmë disa prej tyre sepse bizneset janë shtyllat e një vendi dhe duhet të fuqizohen", ka shprehur Rama në llogarinë e vet në "Facebook".

## Limaj përkujton bashkëluftëtarin Haradin Bala

PRISHTINË, 31 JANAR - Kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka përkujtuar të hënën njërin ndër

veprimtarët më të çmuar të UÇK-së, bashkëluftëtarin e tij, Haradin Bala, në katërvjetorin e vdekjes. "I ndjeri Haradin Bala ishte

njeri i drejtë dhe punëtor. Dha kontribut të madh në luftën e lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe në procesin e

shtetndërtimit të vendit. Lavdi jetës dhe veprës së tij!", ka thënë Limaj, ka njoftuar Nisma Socialdemokrate.



## Zahiri, Edmondi dhe Hakifi ishin lajmëtarët e lirisë

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 31 JANAR - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani-Sadriu, së bashku me kryeministrin Albin Kurti, kanë bërë homazhe dhe kanë vendosur kurorë lulësh të shtatoret e heronjve Zahir Pajaziti, Hakif Zejnullahu, Edmond Hoxha dhe Ilir Konushevi.

Presidentja Osmani ka thënë se sot në përvjetorin e vrasjes së heronjve Zahir Pajaziti, Edmond Hoxha dhe Hakif Zejnullahu jemi këtu së bashku me kryeministrin, me kryetarin e komunës dhe me bashkëpunëtorë për t'i shprehur nderimet tona më të larta për veprimtarinë, për punën dhe për sakrificën që këta heronj kanë bërë për lirinë e Kosovës. "Zahiri me shokë ishin pararoje të UÇK-së, ata ishin lajmëtarët e lirisë sonë. Ishte pikërisht angazhimi i tyre dhe pastaj edhe rënia e tyre për lirinë e Kosovës në një pritë që më vonë frymëzoi edhe

mijëra gra e burra t'i bashkohen luftës çlirimtare që më në fund kulmoi edhe me çlirimin e vendit tonë", ka thënë Osmani.

Presidentja Osmani ka theksuar se ky frymëzim nuk ka përfunduar në vitin 1999 me çlirimin e vendit tonë, por vazhdon edhe sot e, për shkak të punës, veprimtarisë, sakrificës dhe luftës së tyre çlirimtare, ata do të mbesin udhërrëfyes të brezave që do të vijnë edhe pas nesh. "I përjetshëm qoftë kujtimi për ta, sepse do të vazhdojnë të jetojnë në zemrat dhe mendjet e të gjithë qytetarëve të Kosovës të cilët sot bashkërisht e gëzojnë lirinë për shkak të sakrificës së Zahirit, Edmondit, Hakifit dhe shumë e shumë vajzave e djemve që ranë për lirinë e Kosovës", ka pohuar presidentja.

Ndërkaq, kryeministri Albin Kurti ka thënë se komandanti Zahir Pajaziti ishte ndër pararendësit e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. "Ai bashkë me Hakif Zejnullahun dhe Edmond Hoxhën kryenin



aksione kundër okupatorit edhe para se të fillojë lufta çlirimtare. Zahir Pajaziti, Edmond Hoxha dhe Hakif Zejnullahu ishin

kushtrimi i çlirimit dhe ata i dhanë një hov të jashtëzakonshëm Ushtrisë Çlirimtare, e rritën edhe besimin e popullit në UÇK, por edhe vetëbesimin e popullit", ka thënë kryeministri Kurti.

Më pas, presidentja Osmani dhe kryeministri Kurti kanë vendosur kurorë me lule dhe kanë bërë homazhe edhe te varri i heroit Zahir Pajaziti në Kompleksin Memorial "Zahir Pajaziti" në Orllan, në 25-vjetorin e rënies.



### Krasniqi: Flijimi i Zahirit, Hakifit e Edmondit për çlirim është drita e ditëve të bardha të Kosovës

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, ka përkujtuar heronjtë Zahir Pajaziti, Hakif Zejnullahu dhe Edmond Hoxha në 25-vjetorin e rënies së tyre.

Krasniqi ka theksuar se tre heronjtë me zemrën plot dashuri për atdheun e me ideal për çlirimin e tij në mendje, ranë për t'u lartësuar në përjetësi. "Ata që i kanë njohur këta trima, thonë se

jetonin për ta dhënë jetën për Kosovën. Për lirinë që, megjithëse nuk e pritën të gjallë, në mendje dhe shpirt e ndienin se ajo do të vinte përmes guximit dhe sakrificës së tyre. Sot, Zahir, Hakifi e Edmondi, me mijëra çlirimtarë të tjerë që u flijuan në rrugën e çlirimit, janë bërë dritë mbi ditët e bardha të Kosovës. Lavdi e përjetshme!", ka deklaruar Krasniqi.

## Tërmkollit i reagon Lutës: LDK-ja e përnjëmendtë nuk shkon në protesta pas çdokujta

EPOKA  
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 31 JANAR - Ish-ministrja dhe ish-deputetja Melihate Tërmkollit ka reaguuar në lidhje me një deklaratë të nënkryetarit të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lufti Haziri, i cili ka thënë se kjo parti është institucionale dhe nuk merr pjesë në protesta. Ajo përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se LDK-ja e përnjëmendtë nuk shkon në protesta pas çdokujta. "Ose Luta nuk është LDK

ose LDK nuk është më 'institucionaliste'. LDK-ja, ajo që ishte e njëmendtë, jo veç del në protesta, por edhe organizon protesta sa herë që rrezikohet qenia kombëtare, interesat e qytetarëve dhe shtetit tonë. Sigurisht LDK-ja e përnjëmendtë nuk shkon në protesta pas çdokujta, porse fshehja e vazhdueshme pas 'institucionalizmit', edhe kur rrezikohet rëndë interesi i qytetarëve dhe i vendit, është mungesë karakteri e pazargjixhje të shtetit", ka shkruar Tërmkollit. Nënkryetari i Lidhjes Demokratike

të Kosovës, Lufti Haziri, ka thënë se LDK-ja është parti institucionale dhe nuk bën protesta. "S'duhet të kritikohemi pse s'kemi dalë në rrugë, sepse nuk njihemi si parti e tillë. Ne jemi parti institucionale", ka deklaruar Haziri për "Albanian Post". Ai ka thënë se kjo parti do të vazhdojë ta kundërshtojë shtrenjtimin e rrymës përmes rrugëve institucionale. "Ne politikisht do të vazhdojmë ta kundërshtojmë me të gjitha mjetet brenda institucioneve të shtetit", ka deklaruar ai.



# Dërgohen komentet për strukturën e re tarifore të propozuar nga ZRRE-ja



**Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) në Kosovë ka bërë me dije se, pas pranimit të të gjithë komenteve në kuadër të shqyrtimit të jashtëzakonshëm të tarifave të energjisë elektrike, do të dalin me një raport përfundimtar rreth tarifave të reja të energjisë**

**EPOKA E RE** **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 31 JANAR - Të hënën ka përfunduar afati për dhënien e komenteve formale ndaj propozimit të Zyrës së Rregullatorit për Energji lidhur me shtrenjtimin e energjisë elektrike. Zyra e Presidentes së Republikës së Kosovës të hënën ka dërguar komentet në raportin konsultativ të Zyrës së Rregullatorit për Energji mbi Shqyrtimin e Strukturës Tarifore për Konsumatorët e Rregulluar të Amvisërisë të Shërbyer nën FShU.

Në këtë dokument janë paraqitur qëndrimet e Zyrës së Presidentes lidhur me strukturën e re tarifore të propozuar nga ZRRE-ja dhe janë dhënë rekomandime konkrete të cilat do të rezultojn me respektim të parimit të mos diskriminimit, përbalueshmërisë, qasjes së barabartë dhe furnizimit të rregullt me energji. Ndër të tjera, në këto komente është potencuar se: "Për presidenten e Republikës së Kosovës, objektiv kryesor mbetet respektimi i parimit të përbalueshmërisë, qasjes së barabartë, dhe furnizimit të rregullt me energji elektrike. Nisur nga kjo, kërkohet nga ZRRE që, ashtu siç e ka cekur vetë në dokumentin e publikuar, të sigurohet që 'konsultimi

publik [të jetë] në qendër të politikave rregullatore efektive. Respektivisht, ZRRE-ja ftohet që me seriozitet t'i trajtojë komentet dhe rekomandimet e palëve të interesit dhe t'i integrojë ato në mënyrë adekuate në dokumentin final, në mënyrë që struktura e re tarifore të mos jetë diskriminuese dhe e papërbalueshme ndaj grupeve të caktuara të konsumatorëve në vend", është theksuar në njoftimin e Presidencës. Edhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ka dërguar të hënën komentet kundërshtuese për çmimin e energjisë elektrike në ZRRE. Lajmin e kanë bërë me dije zyrtarë të kësaj partie në një konferencë për media. "LDK-ja kundërshton ngritjen e çmimit të energjisë elektrike për qytetarët e Kosovës. Propozimi aktual i ZRRE-së, duke i trajtuar qytetarët në mënyrë të pabarabartë, ku një kategori i subvencionohet 100 për qind tarifa, ndërsa të tjerave jo, është akt diskriminues dhe në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, përkatësisht parimit të barazisë së qytetarëve para ligjit", ka thënë anëtari i kryesisë së LDK-së, Xhafer Tahiri. Ai ka theksuar se tarifën e propozuar janë të papërbalueshme, andaj LDK-ja kërkon që ato të mbeten të pandryshuara deri në fund të

këtij viti, e qytetarët të kenë mundësi e kohë, madje edhe të subvencionohen nga qeveria për tranzicion nga ngrohja me energji në ngrohje të tjera alternative e më ekonomike.

Edhe Lëvizja Vetëvendosje ka njoftuar se kanë dërguar komentet e tyre në ZRRE. Gjithashtu komente ndaj ZRRE-së ka dërguar edhe AAK-ja. "Vazhdimin e kundërshtimit tonë ndaj tarifave diskriminuese të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) dhe qeverisë e bëmë edhe me komentet tona kundërshtuese kundër ngritjes së çmimit të rrymës, të dorëzuara sot në Zyrat e ZRRE-së. Grupi parlamentar i AAK-së kundërshton çmimin e papërbalueshëm të tarifave, duke përfshirë edhe bllok tarifave e propozuara nga ZRRE-ja dhe kërkon nga ZRRE-ja dhe qeveria ta kthejë në rivlerësim të plotë procesin", ka bërë me dije shefi i grupit parlamentar të AAK-së, Besnik Tahiri.

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, ka thënë se partia që drejton nuk ka dërguar komente për këtë çështje në adresë të ZRRE-së, sepse ato i ka bërë publike në vazhdimësi. "Ne konsiderojmë se përtej komenteve formale, ZRRE në vendimin e saj duhet të marrë për bazë të gjitha diskutimet publike, qëndrimet politike dhe disponimin qytetar në lidhje me kërkesën për ngritje të çmimit të energjisë elektrike. Si parti politike në vazhdimësi kemi paralajmëruar se do të ketë krizë energjetike në Kosovë dhe në paraqitjet publike kemi shprehur qëndrimin tonë kundër rritjes së çmimit të energjisë. Për këtë kemi ftuar edhe seancë të jashtëzakonshme në Kuvendin e Kosovës, ku i kemi

dhënë edhe propozimet tona, si dhe kemi ofruar argumente profesionale për çmimin e diskutimeve në komisionin parlamentar për ekonomi, industri, ndërmarrësi dhe tregti", ka thënë Krasniqi.

Ai ka thënë se vendosja e bllok-tarifave për çmimin e energjisë nga ana e ZRRE është veprim i gabuar që trajton padrejtësisht shumicën e qytetarëve dhe, si i tillë, është vendim politik i ndikuar nga Qeveria e Kosovës, që do ta rëndojë edhe më tepër xhepin e qytetarëve të Kosovës. "Po ashtu, rritja e paralajmëruar nga ZRRE prej 42-përqindësh në total, e që për shumë konsumatorë do të shkojë në mbi 100 për qind, është e pashembullt, e panevojshme dhe e paarsyeshme. Edhe më keq, propozimi i ZRRE-s nuk i përfshin fare komunat në veri të vendit, të cilat edhe ashtu nuk paguajnë fare energji. Kjo ndarje është e paligjshme dhe e padrejtë ndaj qytetarëve të tjerë të Republikës së Kosovës. Përtej kësaj, ky është një rrezik që avancojnë tendencat autonomiste në veriun e vendit", është shprehur ai për të shtuar se: "Qeveria e Kosovës ka përgjegjësi për çdo vendim në lidhje me përcaktimin e çmimit të energjisë elektrike që do ta marrë ZRRE dhe çfarëdo arsyetimi është vetëm në funksion të ikjes nga kjo përgjegjësi që e kanë. PDK-ja do ta kundërshtojë çfarëdo vendimi për rritje të çmimit të energjisë në këtë fazë, duke i shfrytëzuar të gjitha instrumentet ligjore në dispozicion", ka deklaruar Krasniqi.

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) në Kosovë ka bërë me dije se pas pranimit të të gjithë komenteve në kuadër të

shqyrtimit të jashtëzakonshëm të tarifave të energjisë elektrike, do të dalin me një raport përfundimtar rreth tarifave të reja të energjisë.

ZRRE-ja gjatë procesit të konsultimit publik deri më tani ka pranuar komente nga palë të ndryshme të interesit si: Sekretariati i Komunitetit të Energjisë në Vjenë, Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP), Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës (KOSTT), Kompania Kosovare për Shpërndarje të Energjisë Elektrike (KEDS) dhe Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike (KESCO).

Kryesuesi i Bordit të ZRRE-së, Ymer Fejzullahu, në një konferencë për medie, të hënën ka thënë se në mbledhjen e ardhshme të bordit do të bëhen publike tarifën e reja të energjisë. Fejzullahu nuk ka saktësuar datën se kur pritet të mbahet kjo mbledhje. "Pas pranimit të komenteve, ZRRE-ja do të dalë me një raport përfundimtar ku do t'u përgjigjet këtyre komenteve dhe do të vendosë mbi të hyrat e lejuara maksimale për të licencuarit e rregulluar, përkatësisht tarifën", ka thënë Fejzullahu.

Shqyrtim i jashtëzakonshëm i tarifave të energjisë elektrike është bërë me qëllim që të reflektojë mbi çmimet e ngritura të importit të rrymës si pasojë e krizës globale energjetike.

Aktualisht, konsumatorët e Kosovës paguajnë 6.75 centë për kilovat në orë.

ZRRE-ja ka dalë me propozimin për rritje të faturave më 17 janar. Ajo ka bërë ndarjen e konsumatorëve në pesë kategori: A, B, C, D, E.

Siç shpjegohet në Raportin Konsultativ të ZRRE-së, rritja e çmimit të energjisë prek vetëm dy kategori të amvisërive, D dhe E, përkatësisht ata qytetarë që shpenzojnë mbi 800, përkatësisht mbi 1 000 kilovatë.

Për kategorinë D, që shpenzon 800 kilovatë orë energji elektrike në muaj, fatura pritet të rritet për 12 euro e 31 centë.

Për qytetarët në kategorinë E, që shpenzojnë 1 000 kilovatë orë energji elektrike në muaj, fatura pritet të rritet për 24 euro e 62 centë.

Partitë opozitare kanë kundërshtuar propozimet për rritje të çmimit të energjisë.

Të shtunën në Prishtinë është mbajtur një protestë kundër shtrenjtimit të energjisë elektrike. Ndërkohë, që rritja e faturave të energjisë elektrike të mos jetë aq e lartë dhe të mos bëhet e papërbalueshme për një kategori të qytetarëve, Qeveria e Kosovës ka ndarë një shumë prej 75 milionë eurosh në formë subvencionimi. Këto subvencione vlejné edhe për bizneset, për të cilat, edhe pas propozimit të ZRRE-së nëse miratohet, nuk do të ketë rritje të tarifave të energjisë elektrike.



# Si të mësosh nga dështimet



## Nga Arthur C. BROOKS

E dëshiroje dhe punove fort për ta pasur. Por të gjitha përpjekjet tuaja rezultuan të kota. Ndoshta marrëdhënia juaj romantike ka marrë fund, kompania juaj ka falimentuar ose jeni pushuar nga puna.

Ndoshta keni mbetur në provim edhe pse kishit studiuar shumë, nuk gjetët dot një botues për librin tuaj, ose nuk shënuat dot me portën bosh duke sjellë humbjen e ekipit. Ndjesia që përjetoni në raste të tilla nuk ka të bëjë me keqardhjen, pra me atë që ndjenit ndërkohë që do të kishit dashur të kishit bërë më shumë. Është shumë më e keqe: ju bëtë më të mirën, por edhe kjo nuk mjaftoi.

Ky lloj dështimi është shumë i dhimbshëm, dhe hedhja pas krahëve e tij është ndonjëherë është e vështirë. Nëse libri, ndeshja apo puna ishin të rëndësishme për identitetin tuaj, ju mund të nisni që ta shihni humbjen si pjesë të identitetit tuaj.

Atëherë, çfarë ndodh në raste të tilla? Njeriu mund të mbyllet në vetvete, dhe të shpresojë se koha do t'i shërojë plagët. Por ndoshta ju mund të zgjidhni që të përballeni me vuajtjen dhe ta menaxhoni atë në mënyrë aktive. Në këtë mënyrë, do të përmirësoni jo vetëm gjendjen shpirtërore. Me pak njohuri dhe praktikë, dështimi mund të shndërrohet në një burim rritje, madje edhe lumturie.

## Mendimi obsesiv mbi një dështim që ka ndodhur është kundër-produktiv

Në fillim të karrierës sime si regjisor, në një rast bëra një gabim

që solli një trajtim poshtërues nga ana e medias. I thashë fqinjit tim – një politikan i vjetër që kishte punuar shumë vite në Uashington – se ndihesha si një dështak për shkak të atij incidenti.

Pasi më dëgjo, më tha: “Në një shkallë problemesh që varion nga 0 në 10, pak a shumë ju ju jeni tek 0.25”. Por edhe pse është i vogël në krahasim me të tjerët, çdo dështim ka sërish një shije të hidhur, sidomos kur keni bërë më të mirën. Në mungesë të justifikimeve të thjeshta, ne vazhdojmë të kërkojmë nga vetja shpjegime për dështimin, të cilat thjesht nuk ekzistojnë. Por kjo është një ide e keqe, pasi ta mbash vazhdimisht mendjen tek një dështim që ju ka ndodhur, e mban atë para syve tuaj dhe në qendër të jetës, dhe kjo mund të çojë në dështime të tjera. Ne fillojmë të imagjinojmë një sërë ngjarjesh, që më pas na çojnë drejtë shkatërrimit dhe varfërimit.

Themi me vete: “Më pushuan nga puna. Tani askush nuk do të dojë të më punësojë, do të jem përgjithmonë i papunë dhe mund të humbas edhe shtëpinë. Jeta ime është shkatërruar!”. Dhimbja emocionale pas dështimit na ka ndihmuar të mësojmë të mos provojmë të njëjtën gjë dy herë.

Studime të ndryshme kanë zbuluar se të menduarit vazhdimisht mbi një dështim, ose i pengon njerëzit të ndërmarrin diçka të re, ose i shtyn ata ta bëjnë këtë me një hezitim shumë të madh. Frika dhe mosbesimi shtohen, duke shpërdoruar jo pak shanse për suksese të reja.

Për të kapërcyer gjendjen ku ndodhesha pas dështimit, u konsultova me Xiaodong D.Lin, profesor i studimeve njohëse në

Kolegjin e Pedagogjisë në Universitetin e Kolumbias, SHBA. Lin ka studiuar për vite me radhë dështimet e pashmangshme të shkencëtarëve, sportistëve apo njerëzve të zakonshëm. Ja cilat janë strategjitë që ai rekomandon për të kapërcyer një dështim, madje edhe për të përfutur nga një situatë e tillë:

## Mendoni jo vetëm për dështimet tuaja, por edhe ato të të tjerëve

Mjekët dhe terapistët që trajtojnë frikërat e ndryshme, e kanë ditur prej kohësh se ekspozimi ndaj objektit që e gjeneron frikën, mund ta bëjë atë më të zakonshme dhe kësaj më pak kërcënuese. Duke e thelluar këtë koncept, Lin dhe kolegët e tij kryen disa vite më parë një eksperiment.

Ata u treguan studentëve historitë e sukseseve por edhe dështimeve të shkencëtarëve më të famshëm të botës, ose vetëm sukseset. Studiuësit zbuluan se studimi i dështimeve, i motivonte studentët të menaxhnin më mirë dështimet e tyre, dhe i ndihmoi ata të merrnin nota shumë më të mira sesa bashkëmoshatarët e tyre që mësonin vetëm historitë e sukseseve të shkencëtarëve të njohur.

Edhe studimi i dështimeve tuaja, mund t'i bëjë ato të duken më pak zemër-thyese. Në një artikull të vitit 2010 të botuar në “Nature”, një studiues sugjeroi që njerëzit të mbanin një listë të shkruar të gjërave që u kanë shkuar keq në jetë.

Në pamje të parë mund të tingëllojë si diçka që ju e bëni shpesh në mendje, por është shumë më ndryshe kur e shkruani diku. Mish-mashi i gjërave që sillen në kokën tonë na

detyron shpesh të qëndrojnë në sferën e errët të emocioneve dhe që janë të vështira për t'u menaxhuar. Shkrimi i tyre mund të imponojë një përpjekje konjitive njohëse dhe të ndihmojë për të pasur një këndvështrim më të qartë dhe më logjik mbi ngjarjet, duke treguar anën e tyre pozitive.

## Ndaloni së dëshiruari suksesin

Një nga arsytet pse dështimi mund të jetë psikologjikisht kaq shkatërrues, është se ne i vendosim vetes synimin për të qenë të suksesshëm, në vend se të përmirësohemi si njerëz apo të mësojmë. Synimi drejt suksesit, mund të duket si rruga e duhur, por është në fakt një qasje e gabuar sidomos në një botë të fiksuar pas CV-ve dhe karrierës.

Në një e-mail që më dërgoi në ato kohë, Lin shkruante se vlera që krijojmë në punë dhe në jetë, ka më pak të bëjë me atë që arrijmë dhe më shumë me njohuritë dhe përvojën tonë, duke përfshirë atë që mësojmë pas një dështimi. Ka shumë prova se dështimi është një shtytës shumë i fuqishëm i përmirësimit.

Studiuësit që rishikuan ecurinë akademike të kandidatëve për një bursë kërkimore nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë, zbuluan se ata që nuk patën menjëherë sukses në fillim të karrierës së tyre, kishin ecur më mirë në planin afatgjatë, sesa ata që ishin menjëherë të suksesshëm.

## Mbani në qendër të jetës idealet tuaja

Zakonisht qëllimet e vlefshme motivohen nga diçka më e thellë se sa suksesi. Gjatë bisedave që

zhvilloi me disa fitues të Çmimeve Nobel, Lin vuri në dukje se “të gjithë kishin një pasion të madh dhe një dëshirë të zjarrtë për të zbuluar të vërtetën mbi një problem”.

“Për këta njerëz, fitimi i Çmimi Nobel nuk ka qenë kurrë arsyeja e punës së tyre të palodhur”- theksoi ai. Ai nuk është vetëm një parim etik, por edhe praktik. Fokusimi tek vlerat tuaja thelbësore, ju ndihmon të kuptoni në radhë të parë pse keni vendosur të rrezikoni për të arritur një qëllim.

Disa njerëz përballen me më shumë humbje dhe zhgënjime se sa të tjerët, dhe këtu ndikon fati, rrethanat, gjykimi apo edhe prirja për të ndërmarrë shumë rreziqe. Por pavarësisht se kush jeni, dështimi herët a vonë do të shfaqet edhe në jetën tuaj. Ndaj nuk është e rëndësishme të pyesni veten nëse do të dështoni ndonjëherë, por çfarë do të bëni pasi të ndodhë diçka e tillë.

Ata që kërkojnë një mirëqenie më të madhe, gjejnë kuptim dhe qëllim edhe në pengesat që hasin, dhe më vonë arrijnë të bëhen më të fortë dhe më efektivë. Tomas Edison na ofron ndoshta shembullin më të madh në këtë aspekt.

Një herë një ndihmësi i tij i ri u dëshpërua, pasi po kryente disa herë eksperimente duke dështuar. “Asnjë rezultat”- e kishte pyetur Edison, dhe ai i ishte përgjigjur “Miku im, unë kam pasur shumë rezultate. Tani di gjëra të ndryshme dhe mijëra që nuk do të funksionojnë”. Edhe nëse bëhet fjalë për ndezjen e një llambe, aplikimin për një vend pune apo të kërkuarit e dashurisë, ky është këndvështrimi i duhur mbi dështimin.

“The Atlantic” – Bota.al



**QENDRA SPORTIVE**  
**'BUJQËSIA'**  
TEL: 045/82 82 82

# Apolonia dhe Laçi përfitojnë nga transferimi i Uzunit te Granada



**TIRANË, 31 JANAR** - Vjen hapi i madh i rëndësishëm në karrierën e Myrto Uzunit. Sulmuesi i përfaqësueses shqiptare transferohet në një nga kampionatet më të rëndësishme të Evropës, La Liga, pasi ka marrë një ofertë të pafuzueshme nga një nga klubet e elitës atje, Granada. Lojtari ka shkëlqyer me Ferencvaroshin, duke qenë në një vit e gjysmë atje lideri i repartit të avancuar, duke bindur me lojë dhe me gola të rëndësishëm të shënuar në kampionat dhe në Evropë, ku provoi fazën e grupeve të Ligës së Kampionëve e, së fundmi, edhe të Ligës së Evropës. Paraqitje të cilat kanë tërhequr vëmendjen e klubit të Granadas në Spanjë dhe, sipas medieve hungareze, por

edhe spanjolle, konfirmohet se ai do të jetë destinacioni i tij i radhës. Sulmuesi mungoi në ndeshjen e djeshme të Ferencvaroshit ndaj Ujpeshtit, pasi u konfirmua se ka udhëtuar drejt Spanjës për të firmosur me klubin e ri. Uzuni do t'i kryejë vizitat mjekësore dhe të firmosë për katër vjet me klubin spanjoll përpara mbylljes së merkatos së janarit, e cila në Spanjë, ashtu si në pjesën më të madhe të vendeve evropiane, është mbyllur të hënën, raporton "PanoramaSport". Nga ky transferim përfitojnë edhe klubet shqiptare, Apolonia dhe Laçi, ekipet që e kanë pasur futbollistin pjesë të tyre deri në moshën 23 vjeçe. Ato do të arkëtojnë 3 % të vlerës së transferimit të kartonit, që i

bie rreth 90 mijë euro secila, ndërsa në arkat e Ferencvaroshit spanjollët e Granadës pritet të derdhin një shifër mes 3 deri në 3.5 milionë euro. Uzuni ka spikatur me Ferencvaroshin ku shënoi 36 gola dhe dha 14 asistime në 67 ndeshje. Ndërsa klubi ku po shkon, Granada, renditet në vend të 14-t në La Liga këtë sezon. Pas 22 javësh ata kanë grumbulluar 24 pikë dhe duhet të vazhdojnë ende të punojnë për të siguruar mbijetesën, duke qenë se janë vetëm +6 pikë nga Kadizi i vendit të 18, shkallës së fundit që të zbresë në Segunda. Në La Liga Uzuni do ta zgjerojë hartën e legjionarëve shqiptarë, ku militojnë dhe Bare (Espanyoli) dhe Balliu (Rayall Vallecano).

## SHKURT

### Krasniqi, futbollist i Vëllaznimit

Skuadra e Vëllaznimit, e cila bën gara në Ligën e Parë të Kosovës në futboll, është përforcuar të hënën me një futbollist. Bëhet fjalë për qendërmbrojtësin Jetart Kastratin. Kastrati në të kaluarën ka qenë pjesë e SC Gjilanit si dhe së fundmi pjesë e KF Kika. "KF Vëllaznimi ka arritur marrëveshje me qendërmbrojtësin Jetart Kastrati. Kastrati në të kaluarën ka qenë pjesë e SC Gjilanit si dhe së fundmi pjesë e KF Kika", thuhet në njoftimin e klubit kuqezi.

### Ramsey paraqitet te Rangersi

Mesfushori Aaron Ramsey edhe zyrtarisht është futbollist i Glasgow Rangersit. Ylli uellsian ka kompletuar huazimin te kampionët e Skocisë. Lajmi u bë me dije nga gazetari i njohur Fabrizio Romano. Ai vendosi të largohet nga Juventus, pasi që nuk ishte në planet e trajnerit Massimiliano Allegri. Ramsey kishte ofertë edhe nga Burnley, por në fund vendosi ta pranojë ofertën e gjigantit skocez.

### Ndombele nga Tottenhami kalon në Lyon


Tanguy Ndombele është transferuar te skuadra e Lyonit. Mesfushori që luajti deri në këtë pikë të sezonit me Tottenhamin, Ndombele kërkoi edhe nga Paris Saint Germain, por një tjetër skuadër franceze siguroi nënshkrimin e tij. Ndombele është rikthyer te Lyonit, ku ka nënshkruar një kontratë huazimi. Ndombele do të jetë me Lyonin deri më 30 qershor të vitit 2022 në formë huazimi. Lyonit paguan 1.42 milion euro për huazimin e lojtarit.

## Drejtuesit e FFK-së morën pjesë në mbledhjen e TEP-it

**PRISHINË, 31 JANAR** - Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi dhe ushtruesi i detyrës së sekretarit të përgjithshëm, Taulant Hodaj, morën pjesë në mbledhjen online të TEP (Top Executive Programme) të UEFA-s. Në këtë mbledhje në të cilin mori pjesë presidenti i UEFA-s, Aleksandër Çeferin, u diskutuan disa çështje të rëndësishme në

lidhje me futbollin evropian, teksa tema kryesore ishin çështjet që kanë të bëjnë me kompeticionet e UEFA-s, kualifikimet e Evropianit dhe Liga e Kombeve. Një tjetër pikë e rëndësishme e kësaj mbledhjeje ishte edhe shqyrtimi i plotësimndryshimit të Statutit të FIFA-s, e ku FFK-ja përmes kryetarit Ademi shprehu mbështetjen për

UEFA-n rreth plotësimeve që duhet bërë në statutin e FIFA-s. Kongresi i FIFA-s do të mbahet në muajin mars dhe FFK-ja do të përfaqësohet nga presidenti Ademi dhe ushtruesi i detyrës së sekretarit të përgjithshëm Taulant Hodaj. Gjithashtu në këtë takim u diskutuan edhe çështje të tjera me të cilat shqetësohen federatat anëtare të UEFA-s.



## Lampardi emërohet trajner i Evertonit

LIVERPOOL, 31 JANAR - Skuadra e Evertonit ka njoftuar se ka emëruar Frank Lampardin trajner i ri. Ish-trajneri i Chelsea ka nënshkruar një kontratë dyvjeçare e gjysmë. Lampardi kishte qenë pa punë për një vit pasi u shkarkua si

trajner i Chelseas në janarin e kaluar. Ai më parë ka drejtuar Derby County. Paul Clement, Joe Edwards dhe Chris Jones do t'i bashkohen ekipit të trajnerit të Lampardit. Ish-mesfushori i Anglisë, Frank Lampard, ka zhvilluar bisedime me Crystal

Palace, Aston Villa dhe Norwich City, për vendet e lira të tyre në 12 muajt e fundit, por nuk ka marrë një punë. Klubi Merseyside ka qenë në kërkim të një zëvendësuesi për Benitezin që nga shkarkimi i spanjollit pas humbjes 2-1 të

Evertonit ndaj Norwichit. Ish-sulmuesi Wayne Rooney, tani në krye të Derbyt, ka thënë se kishte refuzuar mundësinë për t'u intervistuar për këtë punë të premtën.



## Phoenixi i pandalshëm, vjen fitorja e dhjetë radhazi për nënkampionët e NBA-s

PHOENIX, 31 JANAR - Phoenix Suns i arriti fitoren e dhjetë radhazi, duke mposhtur me rezultat 115-110 San Antonio Spursin. Nënkampionët edhe pse vuajtën më tepër nga sa parashikohej, në fund arritën përmbyshjen falë një periodesë të katërt me rezultatin e pjesshëm 36-19 për të nënshtruar më në fund një San Antonio luftarake. Spursat, në fakt, e nisën periodesën e fundit me një avantazh prej 12 pikësh, falë 25 pikëve të shënuara në total nga Doug McDermot dhe 22 nga stoli prej Lonnie Walker, por nuk arritën t'i përgjigjeshin një rezultati të pjesshëm 14-0 nga ana e Phoenixit. Në pesëshen e Sunsit, të gjithë arritën të shënonin numër dyshifrorë pikësh, Chris Paul dirigoj orkestrën me 20 pikë, 8 rikuperime dhe 19 asistime (maksimumi sezonal ky në NBA), duke inspiruar edhe 28 pikë të Devin Bookerit, dhe 26 nga Mikal Bridgesi. Ndërkohë Denver Nuggetsit iu shkaktua një humbje e rëndë, 100-136 kampionëve në fuqi të Milwaukee Bucksit, plot 36 pikë diferencë pa e rrezikuar aspak fitoren në pjesën e dytë. Në sfidën mes dy MVP të fundit të ligës,

Giannis Antetokounmpo e mbylli me 29 pikë, por ishte Nikola Jokiq ai që fitoi duelin. Serbi koleksionoi 15 asistime të cilëve ua shtoi edhe 18 pikë dhe 9 rikuperime në vetëm 28 minuta lojë. Paraqitjes së tij iu



shtuan edhe 24 pikët e Aaron Gordionit, 18 të Monte Morrisit, 15 të Will Bartonit, 14 të ishit Bryn Forbesit dhe 13 të Bones Hylandit për ta arritur fitoren e 6 në 7 ndeshje e fundit. Minnesota Timberwolves mposhti 126-106 Utah Jazzin, që pësoi disfatën e 11 në 13 ndeshjet e fundit. Pa Mitchell, Gobert dhe trajnerin Snyder për shkak të protokollit kundër Covidit, Utah humbi dhe Joe Ingles, për një dëmtim në gju. Miqve nuk u shërbyen kështu 23 pikët e Bojan Bogdanoviçit dhe 22 të Mike Conleyt. Në krahun tjetër Minnesota i gëzohet një prej paraqitjeve më të mira sezonale të Karl-Anthony Towns, që firmosi të parën triple-double në karrierë duke e mbyllur ndeshjen me 31 pikë, 11 rikuperime dhe 10 asistime. Dallas Mavericks u surprizua nga një nga skuadrat më të këqija të NBA-s, Orlando Magic,

që fitoi ndaj tyre 110-108. Orlando fiton dy ndeshje radhazi vetëm për herë të dytë në këtë sezon të NBA-s. Teksanëve nuk u mjaftoi triple-double i shtatë sezonal i Luka Donqiqit, autor i 34 pikëve, 12 rikuperimeve dhe 11 asistimeve. Atlanta Hawksi rikuperoi një disavantazh prej shifrash të dyfishta përballë Los Angeles Lakersit për ta siguruar suksesin e shtatë radhazi në shifrat 129-121, një fitore që rrit ambiciet për "play-off"-in, duke përfutur nga mungesa e LeBron Jamesit në radhët e Lakersit. Protagonisti në finale rezultoi Trae Young, që e mbylli me 36 pikë, 4 trepikësha të shënuar dhe 12 asistime. Ndërkohë Onyeka Okongwu shënoi 16 pikë, ndërsa John Collins 20 pikë. Nuk i mjaftoi Lakersit një Malik Monk që shënoi plot 30 pikë, ndërsa të padobishme për të rezultuan edhe 27 pikët e Anthony Davisit.

## Lëndohet Ramosi, në dyshim për ndeshjen kundër Realit

PARIS, 31 JANAR - Lëndimet nuk kanë të sosur për Sergio Ramosin në sezonet e fundit. Sipas "Le Parisien", qendërmbrojtësi ka ndërprerë stërvitjen me PSG-në për shkak të shqetësimit muskolor. Ish-kapiteni i Real Madridit nuk e sheh dritën në fund të tunelit për shkak të problemeve të vazhdueshme fizike dhe kjo po ndodh edhe në kuadër të fazës së 16-të të Ligës së Kampionëve kur të presë ish-skuadrën e tij në "Parc des Princes". I zbankuar në Paris në



verën e kaluar pasi rinovoi dot me "Los Blancos", Ramosi (35 vjeç), nuk ishte në gjendje ta bënte

debutimin e tij me PSG-në deri më 28 nëntor. Që nga ai moment nuk ka arritur të ketë vazhdimësi duke mundur të luajë vetëm pesë ndeshje deri më tani këtë sezon mes kampionatit dhe Kupë së Francës. Spanjollit pati thënë se e kishte të shënuar me të kuqe në kalendar ndeshjen e Ligës së Kampionëve kundër Realit, e cila do të luhet në Paris më 15 shkurt, por duket se do të jetë e vështirë të mbërrijë në kushtet më të mira e aq më tepër për të qenë titullar në qendër të mbrojtjes së PSG-së.

### SHKURT

#### 'Bild': Reali ka arritur marrëveshje me Mbappen

Real Madrid-Kylian Mbappe është një çështje e mbyllur sipas "Bild"-it. Klubi spanjoll dhe sulmuesi francez kanë gjetur pajtim ndërmjet tyre, një marrëveshje e cila do të bëhet zyrtare në fund të këtij sezoni. Mbappe do të transferohet falas në Madrid, ndërsa do të shndërrohet në lojtarin më të paguar 50 milionë euro në sezon. Reali e kërkoi francezin edhe verën e shkuar, madje ofroi edhe një shifër të frikshme 200 milionë euro, por që u refuzua në mënyrë kategorike nga PSG-ja.

#### Erikseni edhe zyrtarisht në Brentford

Brentfordi ka njoftuar se ka nënshkruar me mesfushorin danez Christian Eriksen. Eriksen ka nënshkruar kontratë deri në qershor 2022, me opsion për ta zgjatur edhe për një sezon tjetër. 29-vjeçarit iu implantua ICD pasi pësoi një arrest kardiak gjatë ndeshjes së Danimarkës në "Euro 2020" kundër Finlandës në Kopenhagë. Eriksen ka thënë se zemra e tij nuk është "një pengesë" për t'u rikthyer në lojë. Mesfushori do të kthehet në Londër pasi ka kaluar gjashtë vjet e gjysmë në Tottenham përpara se të largohet për në Inter më 2020.

#### City arrin marrëveshje me Alvarezin

Skuadra kampione e Anglisë, Manchester City, ka njoftuar se ka nënshkruar me yllin e River Plates, Julian Alvarez. 22-vjeçari të hënën nënshkroi marrëveshje pesëvjeçare e gjysmë me kampionin e Premierligës, por përfaqësuesi i Argentinës do të qëndrojë në River Plate deri në përfundim të këtij sezoni dhe do t'i bashkohet skuadrës së Pep Guardiols në verë. Alvarez shihet si një prej sulmuesve më të talentuar me të ardhme të ndritur dhe shumë klube evropiane ishin në garë për të.

#### Morata nuk lëviz nga Juve

Sulmuesi Alvaro Morata ishte duke u kërkuar nga Arsenali, Tottenhami dhe Barcelona, por ai vendosi përfundimisht t'i mbetet besnik skuadrës së Juventusit. Sipas "AS", Arsenali ishte duke provuar të bindë Moratan për kalimin në "Emirates" për pjesën e mbetur të sezonit, por kjo gjë nuk do të ndodhë. Eksperti i transferimeve, Fabrizio Romano, ka konfirmuar se Morata do të qëndrojë deri në fundin e sezonit në Torino.

#### Formula 1 e bën të detyrueshëm vaksinimin për të marrë pjesë në garë

Formula 1 ka vendosur që i gjithë personeli që merr pjesë në gara duhet ta kryejë vaksinën kundër Covidit. Kjo është masë e detyrueshme për të gjithë, pilotë, drejtues, inxhinierë, mekanikë, gazetarë etj. Nuk do të ketë asnjë dallim në këtë çështje, për të evituar çdo lloj problemi në prag të një sezoni të gjatë (23 gara). Gjithçka bëhet për të evituar ndryshime në kalendarin e garave, që shpesh ka pësuar modifikime dy vjetët e fundit. Kjo masë e fundit mund të sjellë ulje të testeve kundër Covidit që pilotët dhe stafet bëjnë çdo fundjavë gjatë garave. Gjithsesi, masat kundër Covidit do të jenë në fuqi dhe ato variojnë nga shteti në shtet. Formula 1 do t'i kërkojë të gjithë personelit të garave që të vaksinohen dhe nuk do të lejojë asnjë përjashtim. Kjo masë është marrë në bashkëpunim me skuadrat, që kanë rënë dakord në prag të sezonit të ri. Ky vendim është miratuar edhe nga bordi drejtues i FIA-s.



**D P A**  
 Departamenti për punë administrative  
 Department for administrative works  
 Prishtinë me 31.01.2022 | Nr. 245

Bazuar në nenin 8 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës të Republikës së Kosovës, nenit 4 të Udhëzimit Administrativ 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, KRU „Prishtina“ sh.a. – Prishtinë, publikon:

**KONKURS PUBLIK**  
**Për plotësimin e vendeve të lira të punës në Kompani**

**I. Nëntë (9) Lexuës-shpërndarës të faturave**

**Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:**

- Lexon për çdo muaj e më së largu tre muaj gjendjen e ujit të shpenzuar përmes ujëmatësit;
- Ngarkohet me material për fatura për çdo muaj, dhe është i obliguar të bëjë shpërndarjen e tyre te secili konsumatorë .
- Gjatë leximit evidentojnë rastet e ujëmatësve në gjendje jo të rregullt, rastet e kyqjeve të paligjshme, abuzim me ujëmatës dhe i raportojnë ato;
- Bënë propozimin e konsumatorëve për shkyqje dhe e perkrah shkyqjen.
- Përgjegjes per perditesimin e adresave te sakta për konsumatorët e zonës;
- I lajmëron prishjet dhe rrjedhjet në shërbimin për konsumator të cilat i shëf në teren dhe i përcjell se a janë rregulluar, etj.

**Kushtet :**

Kandidatët duhet të kenë: - pregaditje të mesme profesionale; - së paku një (1) viti përvojë pune; - të kenë njohuri në përdorimin e kompjuterit; - të kenë njohuri për instrumentet matëse të ujit; - patent për drejtimin e automjetit kategoria „B“.

**Vendet e Punës:** Zonë e veprimtimit të Kompanisë: Prishtinë, Fushë Kosovë, Podujevë dhe Graçanicë.

**Pagat:** Në pajtim me politikën e kompensimit të aprovuar nga Bordi i Drejtorëve.

**Kohëzgjatja e kontratave:** Kohë të pacaktuar, me një periudhë të punës provuese prej 6 muajsh.

**Orari i punës:** 1 plotë.

**Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim për këto pozita:**

- diploma e përgaditjes shkollore;
- kopja e letërnjoftimit;
- çertifikata e lindjes;
- vërtetimi i përvojës së punës.
- patentin për shofer kategoria “B”
- çertifikata që nuk është nën hetime më e re se 6 muaj;

**Procedura për aplikim:** Aplikacioni merret në Kompani ose në web-faqën e Kompanisë, të njëjtit i bashkëngjiten fotokopjet e dokumenteve personale dhe dokumentacioni tjetër të kërkuar sipas Konkursit dhe dërgohen në adresën KRU „Prishtina“ sh.a. në Prishtinë, Rr. „Hazir Shala“ nr.4 në zyrën nr. 44, më së voni deri me datën **15.02.2022** në ora **16.00**.

**Vërejtje:** Kërkesat e kandidatëve me dokumente të pakompletuara do të refuzohen, ato që arrijnë pas afatit nuk do të merren në shqyrtim. Dokumentacioni i dorëzuar përmes postës pranohet brenda afatit prej 72 orësh pas mbylljes së konkursit.

Dokumentacioni pranohet në kopje dhe nuk u kthehet kandidatëve.

KRU “PRISHTINA” SH.A

Rruga “Hazir Shala”nr.4, Prishtinë  
 Tel + 381 38 54 12 11, +381 38 55 10 10  
 Fax + 381 38 54 14 37

www.kru-prishtina.com  
 E-mail:info@kru-prishtina.com



**INVITATION TO TENDER**

The Business Support Center Kosovo – BSCK is implementing “Support to previous returnee start-up beneficiaries through additional equipment as a response to the Covid-19 situation, and other returnees and people at risk of irregular migration through career capacity building measures”. The project is funded by the Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH.

BSCK invites Bidders to submit, free of charge, and without obligation on part of BSCK, a bid on offering Mentoring and Coaching sessions in Career Guidance and Support for 280 beneficiaries – certified from Soft-Skills Training.

Mentoring and Coaching sessions aim to support preparation and promotion of the employment profile, CV-s, motivation letters, and matchmaking/mediating for their labor market entry, to each of the successfully certified beneficiaries from training course.

Interested bidders, can send a request for Terms of Reference via email with reference number **BSCK/81262908/2022** in the subject line to **info@bsckosovo.org**.

The responsible BSCK officer will provide you with Terms of Reference within a day.

Bidders are not allowed to contact or discuss any aspect of the tender with BSCK before closing of the tender as it will lead to automatic disqualification.

Request for Terms of Reference must be sent by e-mail to **info@bsckosovo.org** before 21 February, 2022.

**Application deadline is on 25 February, 2022 at 16:00**



**Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



[www.facebook.com/gjeipuneshpejte](http://www.facebook.com/gjeipuneshpejte)

**RESTAURANT**

**SWISS**

**TAVERNA**

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

**>> SHPALLJE TË VOGLA <<**

► Fatmir Dujaka Gjakovë shpall të pavlefshme diplomën e Q.A.P. Gjakovë, Elektricitist.

► Ruhan Shala shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme Teknike Podujevë.

► Autotaksi "Rasim Beqiri "B.I shpalle te pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb : 810355835.

► Ilir Sadiku shpalle te pavlefshme certifikatën e statusit martesor me numër 10314522 leshuar me daten 17.11.2021.

► Bahri Rama shpalle te pavlefshme diplomën e SHMLT "Arkitekt Sinani".

► Plan B Shpk shpalle te pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb :811429382

► Lëshoj banës me qira në lagjen “Dardania” në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

